



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE FINANCIARE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE
KONTROLLUESE

Nr. 1757 Prot.

Tiranë, më 18/12/2014

UDHËZIM

Nr 28 Datë 18/12/2014

**“PËR PROCEDURAT E MBYLLJES SË LLOGARIVE VJETORE
TË BUXHETIT PËR VITIN 2014”**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 38 të Ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe në vijim të Udhëzimit Nr.2, datë 6.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 260:

UDHËZOJ

I. Përmbajtja dhe publikimi i Pasqyrës Financiare Vjetore të Konsoliduar të Shpenzimeve dhe të Ardhurave të Qeverisjes së Përgjithshme.

1. Për llogari të Buxhetit të Shtetit të vitit 2014, në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme përfshihen:
 - a. të gjitha të ardhurat e arkëtuara, të regjistruara në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ) nga data 1 Janar 2014 deri në 31 Dhjetor 2014 (duke përfshirë datën 31 Dhjetor 2014);
 - b. të gjitha shpenzimet publike të ndodhura (të dokumentuara) nga data 1 Janar 2014 deri në 31 Dhjetor 2014, të njohura brenda kufirit të fondeve buxhetore disponibël dhe të regjistruara në sistemin informatik financiar të qeverisë për llogari të vitit 2014, pavarësisht nga data e kryerjes së pagesave.
2. Për llogari të buxhetit të shtetit 2014, në pasqyrën vjetore të konsoliduar të shpenzimeve dhe të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme, në seksionin e financimit të deficitit fiskal përfshihen të gjitha transaksionet e regjistruara në SIFQ si më poshtë:
 - a. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara nga shitja/privatizimi i aktiveve afatgjata publike gjatë vitit 2014;

